

|                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
|  | <p align="center"><b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b><br/>         REPUBLIKA KOSOVA<br/>         REPUBLIC OF KOSOVA<br/> <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b><br/>         OPSTINA ORAHOVAC<br/>         MUNICIPALITY OF RAHOVEC</p> |  |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|

|               |                                                                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Për:</b>   | <b>Operatori Ekonomik: LAN GROUP SHPK me adresë në Suharekë</b><br><br><b>Operatorëve Ekonomik</b><br><br><b>Të gjitha palëve të interesuar</b> |
| <b>Nga:</b>   | Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit                                                                                                |
| <b>Lënda:</b> | <b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës                                                                                                        |
| <b>Datë:</b>  | <b>13.12.2023</b>                                                                                                                               |

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **12.12.2023**, në Ora: **22.08 h**, nga Operatori Ekonomik: **LAN GROUP SHPK** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PREPARATE PËR LUFTIMIN E INSEKTIT CIKADIA E HARDHISË SË RRUSHIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-13062-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-068-1-2-1**, nxjerr:

#### **VENDIM**

- I. **HEDHET POSHTË** si e jashtë afatshme Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **LAN GROUP SHPK** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PREPARATE PËR LUFTIMIN E INSEKTIT CIKADIA E HARDHISË SË RRUSHIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-13062-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-068-1-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtejshëm për këtë aktivitetin të prokurimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **LAN GROUP SHPK** me adresë në **Suharekë**, si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, me datë: **12.12.2023**, në Ora: **22:08 h**

***Shih tabelën nëpërmjet sistemit te e-prokurimit:***

| 1. Kërkesat për rishqyrtim |                   |                        |                  |                           |                         |
|----------------------------|-------------------|------------------------|------------------|---------------------------|-------------------------|
| Data e dërgimit            | Ofertuesi         | Përshkrimi             | Statusi kërkesës | Afati i fundit për vendim |                         |
| 12.12.2023 22:08           | LAN GROUP SH.P.K. | KERKESE PER RISHQYRTIM | Paraqitur        | 2d 13h 40m                | <a href="#">Detajet</a> |
| <div>Vazhdo ▶</div>        |                   |                        |                  |                           |                         |

### **BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS**

Operatori Ekonomik: **LAN GROUP SHPK** me adresë në **Suharekë**, ka bërë kërkesë për rishqyrtim përmes e-prokurimit me datë: **12.12.2023**, në Ora: **22:08 h**

Në bazë të paragrafin 1 të nenit 5 të LPP-së , **Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune.** Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit., **Në bazë të nenit të lartpërmendur Kalkulimi i afatit kohorë të kërkesës së parashtruar për ri-shqyrtim nga ana juaj fillon së numëruari nga dita e sotme.** Ndërsa në **bazë të nenit 60 paragrafi 1 pika a e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik** e cila përcakton si në vijim:

*“Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se e njëjta duhet te parashtrohet **së paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.** Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)”* .

Me qenë se për Aktivitetin e Prokurimit **FURNIZIM ME PREPARATE PËR LUFTIMIN E INSEKTIT CIKADIA E HARDHISË SË RRUSHIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-13062-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-068-1-2-1**, hapja e tenderëve apo data e fundit për dorëzim të ofertave është parapara data **13.12.2023 në 14:00 h**, **Autoriteti Kontraktues vjen në përfundim se ju si Operator Ekonomik kërkesën për ri-shqyrtim e keni parashtruar në kundërshtim me të nenit 60 paragrafi 1 pika a e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik**, pra jashtë afatit kohorë të përcaktuar me legjislacionit e prokurimit publik dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

**Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:  
Zyra e Prokurimit  
Komuna e Rahovecit